



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.1025/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Milena Đerić kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi, anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e Hekuran Soba, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1025/2021, paraqitur nga Hekuran Soba, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në Vendvotimin VV 0202X/14R, në Komunën e Gjakovës.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga Hekuran Soba, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se në Vendvotimin VV 0202X/14R, i ka shtatë vota mirëpo pretendon se ka më shumë pasi që në atë vendvotim ka votuar ai personalisht si dhe shumica e familjarëve të tij. Në mbështetje të pretendimeve të saj nuk ka paraqitur asnjë dëshmi si provë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Hekuran Soba, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në Vendvotimin VV 0202X/14R, në Komunën e Gjakovës është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e tij nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkrete por janë vetëm pretendime të supozuara andaj këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Kështu që Paneli vlerësoi se apeli nuk është i bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1025/2021 më datën 07.11.2021**

**Kryesuesi e Panelit
Milena Đerić**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.